



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria Ekonomisë -Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy

Departamenti i Energjisë

Divizioni i Sistemeve të Energjisë

MONITORIMI I SISTEMEVE TË ENERGIJË

RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2025



Shtator 2025

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Tabelat.....	4
Figurat	4
1. Hyrje	5
2. Sistemet e energjisë elektrike.....	5
2.1. Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike.....	5
2.1.1. Prodhimi i energjisë elektrike.....	5
2.1.2. Operimi i njësive gjeneruese me linjit	6
2.2. Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike	8
2.3. Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike.....	9
3. Tregu i energjisë elektrike	10
3.1. Bursa ALPEX dhe HUPEX e energjisë elektrike	11
3.2. Shkëmbimet e energjisë elektrike me Shqipërinë	12
3.3. Importi dhe Eksporti i energjisë elektrike	13
4. Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët.....	14
4.1.Tarifat e energjisë elektrike.....	14
4.2. Konsumi dhe Ngarkesat Maksimale	15
5. Sistemet e ngrohjes qendrore	15
5.1. Ngrohtorja Qendrore e Prishtinës - Termokos	16
5.1.1. Tarifat e energjisë termike NQ “Termokos”	17
5.1.2 Përmirësimi i kapaciteteve të ngrohtores Termokos	17
5.2. Ngrohtorja Qendrore e Gjakovës	18
5.2.1 Tarifat e energjisë termike NQ “Gjakova”	19
6. Çështjet mjedisore në sistemet e energjisë.....	19
7. Të gjeturat dhe rekomandimet	20
7.1. Të gjeturat	20
7.2. Rekomandimet	21
Aneks 1 – Kapacitetet aktuale prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë.....	23

Shkurtesat

ALPEX	Bursa Shqiptare e energjisë elektrike
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CO ₂	Dyoksidi i karbonit
GWh	Gigavat orë
HUPEX	Bursa Hungareze e energjisë elektrike
IED	Industrial Emissions Directive/ Direktiva e Emetimeve Industriale
KfW	Banka Gjermane për zhvillim
KEDS	Operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
km	Kilometër
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
kV	Kilovolt
LCP	Impiantet e mëdha me djegie
m ²	Metër katror
MVA	Megavolt amper
MW	Megavat
MWh	Megavat orë
MW el	Megavat elektrik
MWth	Megavat termik
MWhth	Megavat ore termike
NQ	Ngrohtore Qendrore
NO _x	Oksidet e azotit
OSSH	Operatori i sistemit të shpërndarjes
PKZE	Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve
PM	Grimcat e pluhurit
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition/ Kontrolli Mbikëqyrës dhe Marrja e të Dhënave
SO ₂	Dyoksidi i sulfurit
TC	Termocentral
WBIF	Western Balkans Investment Framework/ Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Tabelat

Tabela 1. Kapacitetet e njësive prodhuese të energjisë elektrike.....	5
Tabela 2. Prodhimi i energjisë elektrike përgjatë muajve sipas burimit energjetik dhe krahasimi me vitin 2024	6
Tabela 3. Operimi i njësive gjeneruese	7
Tabela 4. Nënstacionet në rrjetin e transmetimit	9
Tabela 5. Linjat në rrjetin e transmetimit.....	9
Tabela 6. Linjat në OSSH	10
Tabela 7. Nënstacionet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH.....	10
Tabela 8. IDM Çmimi mesatar dhe volumi total - ALPEX.....	12
Tabela 9. Shkëmbimi i energjisë elektrike në mes të KEK dhe KESH	12
Tabela 10. Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	13
Tabela 11. Struktura e tarifave për konsumatorët me të drejt të Furnizimit me Shërbim Universal	14
Tabela 12. Ngarkesat maksimale dhe minimale	15
Tabela 13. Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore.....	16
Tabela 14. Tarifat e energjisë termike NQ Termokos	17
Tabela 15. Tarifat e energjisë termike NQ Gjakova	19
Tabela 16. Vlerat kufitare të emisioneve nëpër vite sipas PKZE	20
Tabela 17. Vlerat e emisioneve janar-qershor 2025	20

Figurat

Figura 1. Prodhimi i energjisë elektrike sipas burimeve.....	6
Figura 2. Krahasimi i disponueshmerisë së njësive të TC A dhe TC B.....	7
Figura 3. DAM Çmimi mesatar dhe volumet mujore-ALPEX.....	11
Figura 4. Krahasimi i çmimit mesatar ALPX dhe HUPX	12
Figura 5. Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	13
Figura 6. Krahasimi i konsumit nacional 2025 dhe 2024	15

1. Hyrje

Monitorimi i vazhdueshëm i sistemeve të energjisë është thelbësor për të identifikuar pikat kritike, për të analizuar performancën teknike dhe për të ofruar të dhëna të besueshme që ndihmojnë në hartimin e politikave dhe dokumenteve strategjike. Ky raport, mbulon periudhën janar – qershor 2025, përmbledh të dhënat dhe gjetjet kryesore nga procesi i monitorimit, me fokus në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, tregun, konsumin dhe ndikimin e sektorit të energjisë në mjedis.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar mbi funksionimin e sistemeve energjetike në vend si dhe të evidentojë përparimet dhe sfidat me të cilat është përballur sektori gjatë kësaj periudhe. Nëpërmjet treguesve teknikë kryesor, raporti kontribuon në ofrimin e të dhënave kryesore lidhur me performancën e sistemit të energjisë përgjatë periudhës janar-qershor 2025.

Raporti është përgatit nga Divizioni i Sistemeve të Energjisë, në përputhje me nenin 12, pika 1.3 dhe 1.4 të Rregullores (ZKM) Nr. 04 /2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Ekonomisë. Të dhënat për hartimin e këtij raporti janë marrë nga raportimet ditore të KOSTT dhe KEK, raportimet mujore nga KEDS, raportet vjetore të ZRrE-së, raportet mjedisore të KEK, të dhënat nga NQ Termokos dhe NQ Gjakova, PKZh 2025-2027, faqja e Komunitetit të Energjisë, dhe raportet mujore të Bursës ALPEX dhe HUPEX.

2. Sistemet e energjisë elektrike

2.1. Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike

Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar për prodhimin e energjisë elektrike është 1576.266 MW, ndërsa kapaciteti operativ është 1244.366 MW, prej të cilave 960 MW janë termocentrale me bazë linjiti ndërsa 284.36 MW janë nga BRE-ja (centrale nga era, hidrocentrale dhe centrale fotovoltaike dhe një kapacitet i vogël nga bashkëprodhimi), shih tabelën 1 me poshtë. Ndërsa njësitë prodhuese dhe kapacitetet e tyre me në detaje janë të paraqitura në aneksin 1 të këtij raporti. Në periudhën janar – qershor 2025, kapaciteti i instaluar është i njëjtë me atë të vitit 2024.

Tabela 1. Kapacitetet e njësive prodhuese të energjisë elektrike

Njësit prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)		
	Instaluar	Neto	%
Termocentrale (TC A dhe TC B)	1288	960	77.15%
Hidrocentrale	135.904	132.004	10.61%
Centrale me erë	137.160	137.160	11.02%
Panele fotovoltaike	14.002	14.002	1.13%
Bashkëprodhim (Ngrohtorja e Gjakovës)	1.2	1.2	0.10%
Gjithsejtë	1576.266	1244.366	100%

2.1.1. Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike në Kosovë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 është realizuar nga termocentralet (TC “Kosova A” dhe TC “Kosova B”) dhe nga njësitë e prodhimit me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE). Gjatë këtij gjashtëmujori, prodhimi total i energjisë elektrike ka arritur në 2,711,099 MWh, krahasuar 3,393,364 MWh në gjashtëmujorin e

vitit 2024, që përfaqëson një rënie prej rreth 20.11 %. Në kuadër të këtij prodhimi, pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë ka qenë rreth 14.28%, duke përfshirë hidrocentralet, centralet me erë dhe ato solare.

Tabela 2 më poshtë paraqet prodhimin e energjisë elektrike sipas llojit të burimit, krahasuar me gjysmën e vitin paraprak. Prodhimi nga termocentralet ka shënuar një rënie prej 23.05% gjatë gjashtëmujorit të vitit 2025, ku vërehet se prodhimi nga hidrocentralet kishte rënie prej 0.87%, prodhimi nga centralet me erë është rritur për 5.59%, ndërkohë që nga centralet solare është shënuar një rritje prej 43.2%, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024. Sipas figurës 1 vërehet se në periudhën janar- qershor 2025 rreth 85 % të energjisë elektrike është prodhuar nga termocentralet ndërsa pjesa tjetër nga BRE.

Tabela 2. Prodhimi i energjisë elektrike përgjatë muajve sipas burimit energjetik dhe krahasimi me vitin 2024

Muaji/Centralet	Termocentralet	Hidrocentralet	Era	Solare	Total
Janar	523835.984	20626.318	41245.578	1829.370	587537.250
Shkurt	456576.896	12788.777	21955.615	2147.950	493469.238
Mars	464659.216	27810.935	36028.872	2617.617	531116.639
Prill	291357.152	51277.088	31834.176	1829.370	376297.786
Maj	298705.440	32576.645	34483.845	2147.950	367913.880
Qershor	288891.040	14876.344	48378.848	2617.617	354763.848
Total 2025	2,324,026	159,956	213,927	13,190	2,711,099
Total 2024	3,020,192	161,354	202,608	9,211	3,393,364




Figura 1. Prodhimi i energjisë elektrike sipas burimeve

2.1.2. Operimi i njësive gjeneruese me linjit

Disponueshmëria e njësive gjeneruese të Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B ka qenë relativisht e mirë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025. Në tabelën 3 janë paraqitur ndalesat, ndërprerjet dhe disponueshmëria në orë pune për secilën njësi gjeneruese përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, ndërsa në figurën 2 është paraqitur krahasimi për gjashtëmujorin parë të vitit 2025 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

Të dhënat tregojnë se njësitë e TC Kosova B kanë shënuar rënie të vogël në performancën e tyre operative. Njësitë tjera të TC Kosova A kanë operuar me një disponueshmëri të krahasueshme me

vitin 2024, qe tregon një performancë të qëndrueshme për TC Kosova A, me një ngritje të performancës ndërmjet njësive A3, A4 dhe A5.

Tabela 3. Operimi i njësive gjeneruese

Janar-Dhjetor 2024	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	2	3	1	2	1
Ndalesat e pa planifikuara	1	0	1	4	1
Rëniet	4	0	0	4	1
Total	7	3	2	10	3
Orë pune	3567	2592	3058	4145	2760
Orë jashtë pune	1521	2496	2030	943	864
Statusi i Bllokut	40%	30%	30%	47%	32%




Figura 2. Krahësimi i disponueshmërisë së njësive të TC A dhe TC B

Përmirësimi i disponueshmërisë, është një zhvillim i rëndësishëm për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe për mbështetjen e qëndrueshmërisë së sistemit energjetik në përgjithësi.

Me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe besueshmërisë së operimit dhe përmirësimit të komponentës mjedisore të termocentraleve janë duke u bërë investime në:

- **Rehabilitimin dhe modernizimin e njësive A3 të TC Kosova:** Në janar 2025 është shpallur faza e parë parakualifikuese e cila është e hapur deri në korrik 2025. Pastaj do të vazhdohet me fazën e dytë e cila pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2025. Realizimi i projektit do të bëhet gjatë periudhës TM1- TM4 2027. Kostoja e projektit është 137.34 mil€, financuar nga KEK. Përfitimet kryesore të projektit janë: zgjatja e jetëgjatësisë së njësive A3 për 20 vjet; rritja e kapacitetit bruto të energjisë në 215 MW; rritja e kohës vjetore të operimit, dhe dyfishimi i prodhimit në 1.5 milion MWh në vit. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti pritet të bëhet ulja e emetimeve të ndotjes së ajrit (PM, NO_x, SO₂), në përputhje me standardet mjedisore të BE-së.

- **Modernizimin e turbinave B1 dhe B2 të TC “Kosova B”:** Rehabilitimi dhe modernizimi i turbinës në njësine B2 ka filluar, ndërsa në vitin 2026 planifikohet njësia B1. Kostoja e projektit 55 Mil.€, investim nga KEK-u. Në kuadër të këtij projekti do t’i rritet jetëgjatësia e njësive të TCB për periudhën prej 20 deri 25 vjet, gjithashtu pritet të rritet kapaciteti 15 MW për njësi.

2.2. Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike

Sistemi i Transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë përfshin nivelet e tensionit të lartë 400 kV, 220 kV , 110 kV dhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV.

Rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal përmes linjave interkonektive me:

- Shqipërinë, Maqedoninë Veriore, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Rrjeti i transmetimit të sistemit të energjisë elektrike të Kosovës i plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1 për gjithë nivelin e tensionit të lartë.

Përgjatë kësaj periudhe ka vazhduar aktiviteti i investimeve në përfortimin dhe modernizimin e rrjetit të transmisionit, për me tej:

- Zëvendësimi i transformatorit të fuqisë me transformator të ri 40 MVA në: NS Gjakova 1 NS Therandë, NS Prizren 1, NS Peja 1, NS Ferizaj 1, NS Deçan. Ky projekt i takon grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII. Është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente me 26.11.2024 për përgatitjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Ka filluar përgatitja e Strategjisë së prokurimit për lansimin e fazës së parakualifikimit dhe periudha e revidimit të raportit fillestar;
- Përfortimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të energjisë për Kukës-Dragash. Ky projekt i takon grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII. Është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente me 26.11.2024 për përgatitjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Është bërë ri-aplikimi për Grant në kuadër të WBIF për shkak se ka ndryshuar burimi i financimit me kërkesë nga BE-ja;
- Mbështetja e ngarkesës/Nyjat e reja 110/10 (20) kV në Ferizaj. Është energjizuar NS 110/35/10 (20) kV Ferizaji 3 dhe linja 110 kV NS Ferizaj 3 – NS Bibaj, ndërsa gjatë muajit Maj 2025 është energjizuar edhe Linja 110 kV NS Ferizaj 3 – NS Theranda;
- Mbështetja e ngarkesës/Nyjat e reja 110/10 (20) kV në Dragash. Ky projekt i takon grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII. Është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente me 26.11.2024 për përgatitjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Ka filluar përgatitja e Strategjisë së prokurimit për lansimin e fazës së parakualifikimit dhe periudha e revidimit të raportit fillestar;

Projektet e listuara me lartë, janë planifikuar me qëllim të rritjes së përfortimeve në rrjet (plotësim të standardeve) si dhe rritjes së sigursë operuese të rrjetit transmetues. Në tabelat 4 dhe 5 janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit.

Tabela 4. Nënstacionet në rrjetin e transmetimit¹

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1200
400/110	KOSTT	2	4	1200
220/110	KOSTT	3	9	1350
220/35	Feronikel	1	2	320
220/35/10(20) (Besiana)	KOSTT	1	1	40
220/10(20) (Besiana)	KOSTT	-	1	40
220/10(20)	KOSTT	1	2	80
110/35/10(20)	KOSTT	7	8	317.5
110/35/6.3	Trepça	1	2	126
110/6.3	Trepça	-	1	31.5
110/35	Ujmani	1	1	20
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/10(20)	KOSTT	14	26	949.5
110/35	KOSTT	11	19	641
110/10	KOSTT	6	8	252
35/110 (Deçan)	Kelkos	-	1	40
Gjithsej		50	90	6,647.5

Tabela 5. Linjat në rrjetin e transmetimit

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	279.5
220	KOSTT	238.5
110	KOSTT	912.1
Gjithsej		1,430.1

2.3. Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstationet përkatëse të nivelit 35/x kV, 10(20)/0.4 kV dhe 6/0.4 kV. Rrjeti ajror dhe ai kabllor është 29,081 km.

Të dhënat bazike të nënstacioneve dhe linjave përfshirë kapacitetin, transformimin dhe gjatësinë e linjave të sistemit të shpërndarjes janë paraqitur në tabelat 6 dhe 7.

¹ Raporti vjetor 2024 - ZRrE

Tabela 6. Linjat në OSSH

Tensioni (kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjithsej (km)
35 kV	KEDS	484	140	624
10(20) kV	KEDS	1,736	606	2,342
10 kV	KEDS	4,165	904	5,069
6 kV	KEDS	42	8	50
3 kV	KEDS	4	1	5
0.4 kV	KEDS	18,236	2,755	20,991
Gjithsej		24,667	4,414	29,081

Tabela 7. Nënstationet dhe transformatorët sipas nivelit të tensionit në OSSH

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia e instaluar (MVA)
35/10	KEDS	38	87	633
35/10	Privat	11	15	68.4
35/20	KEDS	2	5	40
35/6 kV	Privat	5	12	43
35/0.4kV	Privat	19	29	27
10(20)/0.4	KEDS	2,607	2,702	1,375.32
10(20)/0.4	Privat	3,568	3,585	1,872.69
10/20	KEDS	1	3	14
10/0.4	KEDS	2,896	2,896	918.73
10/0.4	Privat	1,247	1,253	606
6(3)/0.4	KEDS	66	66	12.77
6/0.4	Privat	1	1	1
Gjithsej		10,461	10,654	5,611.91

3. Tregu i energjisë elektrike

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), këtë vit ka vazhduar procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës në përputhje me detyrimet ligjore sipas nenit 37, paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike e cila përcakton se “*Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar dhe jofamiljar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë (10) milion euro, ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës*”.

Më 5 mars të vitit 2025, KESCO si furnizues i shërbimit universal me kërkesë të Rregullatorit ka njoftuar që nga data 1 qershor 2025, të gjithë konsumatorët komercialë që kanë qarkullim vjetor më të madh se 10 milionë euro, ose më tepër se 50 punëtorë do të dalin në treg të hapur.

Konsumatorët jofamiljar gjatë këtij procesi është dashur të paraqesin pranë KESCO dëshmitë nëse përmbushin kriteret e furnizimit me shërbim universal. Kurse, konsumatorët të cilët do të furnizohen me çmime tregu është dashur të lidhin kontratë me një nga furnizuesit e licencuar nga ZRrE. Nëse konsumatori ka dështuar në zgjedhjen apo gjetjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm, ai ka gëzuar të drejtën e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë. ZRrE sipas

dispozitave ligjore, ka përcaktuar Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) si Furnizues i Mundësisë Fundit (FMF).

3.1. Bursa ALPEX dhe HUPEX e energjisë elektrike

Më 31 janar 2024 u lançua tregu një ditë para në Kosovë, e cila përkoi dhe me bashkimin e Tregjeve midis zonës ofertuese të Shqipërisë dhe zonës ofertuese të Kosovës. Gjithashtu me 11 dhjetor 2024 ALPEX në rolin e NEMO-s së bashku me Operatorin e Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë-OST dhe Kosovës-KOSTT, filluan operimin me sukses të Tregut të Ankandeve Plotësuese Rajonale Brenda të Njëjtës Ditë (CRIDA) midis Shqipërisë dhe Kosovës si bashkim tregjesh.

Sipas raporteve mujore të ALPEX, në **Tregun e Ditës në Avancë** në periudhën janar-qershor 2025, rrjedha e energjisë nga zona e ofertimit të Shqipërisë drejt zonës së ofertimit të Kosovës ishte 57,507.98MWh, ndërsa nga zona e ofertimit të Kosovës drejt zonës së ofertimit të Shqipërisë ishte 34,140.71MWh.

Në figurën 3 janë të paraqitura volumet totale dhe çmimi mesatar për Kosovë për periudhën janar-qershor 2025 ku në Tregun e Ditës në Avancë të ALPEX, një volum total prej 376,547 MWh u tregtua për zonën e ofertimit të Kosovës me një çmim mesatar 118.54 €/MWh. Çmimi mesatar mujor me i lartë ka arritur në muajin shkurt 162.75 €/MWh, siç shihet edhe në figurën me poshtë, kurse volumi me i lartë total prej 89,804 MWh u tregtua në muajin Qershor. Nëse e krahasojmë çmimin mesatar për muajt shkurt-qershor 2025 me të njëjtën periudhë të vitit 2024 atëherë, ka një rritje prej 46%.




Figura 3. DAM Çmimi mesatar dhe volumet mujore-ALPEX

Sa i përket **Tregut të Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë**, rrjedha e energjisë nga zona e ofertimit të Shqipërisë drejt zonës së ofertimit të Kosovës ishte 2188.0 MWh, ndërsa nga zona e ofertimit të Kosovës drejt zonës së ofertimit të Shqipërisë ishte 2281.9 MWh. Një volum total prej 5,841 MWh i energjisë elektrike u tregtua në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë të ALPEX-it (Kosovë dhe Shqipëri) me një çmim klerues mesatar prej 143.47 €/MWh.

Tabela 8. IDM Çmimi mesatar dhe volumi total - ALPEX

IDM	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Çmimi Mesatar (€/MWh)	210.61	190.45	125.65	112.66	99.22	122.22
Çmimi max. ditor	300	348.69	750.28	750.28	145	220.92
Çmimi min. ditor	70	1	30.71	5	56.03	23.23
Volumi Total (MWh)	794.33	490.33	357.53	195.05	832.9	3170.66

Sipas raporteve mujore të ALPEX dhe HUPX, në figurën 4 është paraqitur krahasimi i çmimit mesatar mujor i bursës ALPEX dhe HUPX, ku shihet një ngritje e çmimit mesatar ne ALPEX nga muaji prill ne krahasim me HUPX. Çmimi mesatar në periudhën janar-qershor 2025 i ALPEX ka qenë 118.54 €/MWh ose rreth 8 % me i lartë se në HUPX me 109.73 €/MWh.




Figura 4. Krahasimi i çmimit mesatar ALPX dhe HUPX

3.2. Shkëmbimet e energjisë elektrike me Shqipërinë

Sipas të dhënave të pranuara nga KEK, gjatë periudhës janar-qershor 2025 ka vazhduar shkëmbimi i energjisë elektrike (energji për energji) në mes të KEK dhe KESH. Eksporti (deponimi në KESH) total i energjisë elektrike si shkëmbim energji për energji në mes të KEK dhe KESH gjatë kësaj periudhe ka qene 3,550 MWh, kurse importi (marrja nga KESH) ka qenë 1,050 MWh. Nga të dhënat e pranuara nga KEK me dt.01.07.2025, rezulton se KEK është borxh të KESH në sasinë prej 884 MWh. Në tabelën 9 është paraqitur eksporti dhe importi si shkëmbim i energjisë elektrike në mes të KEK dhe KESH për muaj.

Tabela 9. Shkëmbimi i energjisë elektrike në mes të KEK dhe KESH

Shkëmbimi me KESH-in	Totali	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Eksport (MWh)	3,550					1,155	2,395
Import (MWh)	1,050			1,050			

3.3. Importi dhe Eksporti i energjisë elektrike

Nga të dhënat e pranuar nga KOSTT, importi i realizuar për janar-qershor 2025 ka qenë 984642.43 MWh, kurse eksporti 59258.07 MWh. Pjesëmarrja e importit ndaj kërkesës ka qenë rreth 28%. Importi i energjisë elektrike për periudhën janar-qershor 2025, është 144% më i lartë se në periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Tabela 10. Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

MWh	Total Import	Total Eksport	Net Import/Eksport
Janar	260400	1994	-258406
Shkurt	228321	933	-227388
Mars	124568	14997	-109570
Prill	168064	11898	-156166
Maj	101865	15960	-85905
Qershor	101424	13476	-87949
Total	984642.43	59258.07	-925384.36

Në tabelën 10 janë paraqitur të dhënat e importit dhe eksportit për periudhën janar-qershor 2025, ku gjithashtu vërehet se Kosova ka qenë neto importuese e energjisë elektrike në sasi prej 925384.36 MWh, e cila është e paraqitur sipas muajve në figurën 5.




Figura 5. Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

4. Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët

4.1. Tarifat e energjisë elektrike

Në prill 2025, ZRrE ka aprovuar tarifatat me pakice të energjisë elektrike për të gjitha kategoritë e konsumatorëve me të drejtë Furnizimit me Shërbim Universal me rritje prej 16.1%, që kanë filluar të mbledhen nga data 1 maj 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Struktura e tarifave për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal janë paraqitur në tabelë 11.

Tabela 11. Struktura e tarifave për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Propozimi
1	35 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		14.54
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		7.61
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.40
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.11
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87
2	10 kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		6.00
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.56
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.44
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.80
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.34
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.87
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.70
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.46
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.87
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.87
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	11.47
			€/kWh	Tarifë e Lartë	13.92
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	6.90
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		0-800kWh (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.05
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.88
		>800kWh (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e Lartë	15.43
			€/kWh	Tarifë e Ulët	7.28
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		0-800 (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifë e vetme	7.12
		>800 (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifë e vetme	12.39
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.32
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	9.05
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.17
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	12.01
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars					
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator					
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me cos(Φ)<0.95					

4.2. Konsumi dhe Ngarkesat Maksimale




Figura 6. Krahasimi i konsumit nacional 2025 dhe 2024

Nga të dhënat ditore të pranura nga KOSTT, konsumi nacional në periudhën janar-qershor 2025 ka qenë 3,486,866 MWh, 9.36 % më i lart se në periudhën e njëjtë në vitin 2024. Nëse i shikojmë muajt janar dhe shkurt kur dhe ngarkesa e sistemit është më e lartë, atëherë konsumi ka qenë rreth 13% dhe 19% më i lartë në këta muaj në vitin 2025 në krahasim me vitin 2024. Në tabelën 12 janë paraqitura në baza mujore ngarkesat maksimale dhe minimale për periudhën janar-qershor 2025.

Tabela 12. Ngarkesat maksimale dhe minimale

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Maksimale (MW)	1435	1474	1192	1121	855	779
Minimale (MW)	630	968	381	341	322	317

Ngarkesa maksimale (piku) në sistemin e energjisë elektrike të Kosovës është regjistruar me datë 20 shkurt 2025 në orën 23:00 me vlerë 1474 MW, që është më e lartë se ngarkesa maksimale që është regjistruar me 11 janar 2024 në ora 23:00 me vlerë 1363 MW. Kurse, ngarkesa minimale është regjistruar me 07 qershor 2024 me vlerë 317 MW në ora 6:00 në krahasim me vitin 2024 ngarkesa minimale ka qenë me 26 maj me vlerë 311 MW në ora 6:00.

5. Sistemet e ngrohjes qendrore

Sektori i ngrohjes qendrore, është një ndër sektorët shumë të rëndësishëm, që ndikon në mirëqenien e qytetarëve, ekonominë e vendit dhe mbrojtjen e ambientit. Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson afërsisht 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

Sektori i energjisë termike në Kosovë përbëhet nga katër sisteme të energjisë termike (ngrohjes qendrore): NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe në Zveçan.

Ngrohtorja Termomit- Mitrovicë dhe e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i përgjigjen kërkesave për licencim / rregullim dhe monitorim nga ZRRE-ja, kështu që është i pa

mundur sigurimi i të dhënave për zhvillimet në këto ngrohtore, andaj dhe nuk trajtohen me tej në kuadër të këtij raporti.

Implantet për prodhimin e energjisë termike të NQ Termokos përbëhen nga ngrohtorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 120 MW_{TH}, dhe ngrohtorja ndihmëse në Qendrën Klinike Universitare me kapacitet prej 14 MW_{TH}. Me kycjen e stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B, këtij kapaciteti i është shtuar edhe kapaciteti i instaluar i bashkëprodhimit prej 140 MW_{TH}. Duhet theksuar se kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos nuk janë dekomisionuar por ato shërbejnë si kapacitet rezervë për tu aktivizuar në rastet e ndonjë avarie eventuale në njësitë e TC Kosova B.

Ngrohtorja e re me biomasë e qytetit Gjakova është e pajisur me dy njësi për prodhimin e energjisë termike me kapacitet të instaluar 2 x 5.5 MW_{TH}, pra 11 MW_{TH}, njësinë e bashkëprodhimit me kapacitet të prodhimit të energjisë termike prej 4 MW_{TH} dhe kapacitet të prodhimit të energjisë elektrike 1.2 MW_{EL}. Pra Ngrohtorja e re me biomasë ka një kapacitet të përgjithshëm të instaluar të prodhimit të energjisë termike prej 15 MW_{TH} dhe kapaciteti e prodhimit të energjisë elektrike 1.2 MW_{EL}. Kapacitetet aktuale të sistemeve të ngrohjes qendrore Termokos dhe NQ Gjakova janë të paraqitura në tabelën 13.

Tabela 13. Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW _{TH}]	Kapaciteti operacional [MW _{TH}]	Rrjeti i energjisë termike	
			Gjatësia e rrjetit(trasesë) [km]	Nr. i nënstacioneve
TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 58 = 116	2 x 49.3 = 98.6	Rrjeti i shpërnd.	
	2 x 7 = 14	2 x 6.3 = 12.6	47.8	920
	1 x 4 = 4	3.6	Rrjeti i Transp.	(aktive- 900)
	[bashkëprodhimit] 2 x 70 = 140	2 x 68.7 = 137.4	10.5	
Nën-total	274.0	252.2	58.3	920
NQ GJAKOVA (Gjakovë)	2 x 5.5 = 11	2 x 5.5 = 11	Rrjeti i shpërnd.	390
	[bashkëprodhimi *] 1 x 4 = 4	[bashkëprodhimi *] 1 x 4 = 4	20.5	(aktive- 257)
Nën-total	15.0	15.0	20.5	390
Total	289.0	267.2	78.8	1,310 (Aktive – 1,157)²

*Njësia e kogjenerimit e NQ Gjakova ka kapacitetin termik 4MW_{TH} dhe kapacitetin elektrik 1.2 MW_{EL}

5.1. Ngrohtorja Qendrore e Prishtinës - Termokos

Sezoni i ngrohjes 2024/2025 ka përfunduar me datë 15.04.2025. Vendimi për përfundimin e sezonit është marrë në harmoni të plotë me Rregulloren e ZRRE për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji termike si dhe duke u bazuar në kushtet klimatike të dhëna nga parashikimet e meteorologëve. Sipas NQ “Termokos” përgjatë 181 ditëve furnizimi me energji termike janë

² <https://www.ero->

[ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202025/Raporti%20vjetor%202024_ZRRE_0_1.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202025/Raporti%20vjetor%202024_ZRRE_0_1.pdf)

prodhuar rreth 362,520 MWh kurse janë liferuar rreth 307 GWh energji termike apo 10% më shumë se në sezonin e kaluar.³

Po ashtu sipas të dhënave zyrtare të NQ “Termokos” gjatë sezonit 2024/2025 numri i përgjithshëm i konsumatorëve të kyçur në rrjet dhe sipërfaqja ngrohëse ka arritur në gjithsej 25,283 konsumatorë prej nga 23,026 janë konsumatorë familjarë kurse 2,362 konsumatorë komercial dhe institucional me sipërfaqe të përgjithshme ngrohëse prej 2.3 mil. m².

5.1.1. Tarifat e energjisë termike NQ “Termokos”

Bazuar në Rregulloren ZRRE/Nr. 01/2022 - për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike me të cilën përcaktohen tarifat e ngrohjes në sektorin e rregulluar të energjisë termike. Kjo rregullore zbatohet për ndërmarrjet që kanë licencë për prodhim, shpërndarje dhe furnizim të energjisë termike. Tarifat e energjisë termike të rregulluara për sezonin ngrohës 2024/2025 janë si vijon:

Tabela 14. Tarifat e energjisë termike NQ Termokos

TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ TERMOKOS - Sezoni 2024/2025			
A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.76	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	35.05	
B: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.11	0.14
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.65	0.81
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.76	0.95

5.1.2 Përmirësimi i kapaciteteve të ngrohësve Termokos

NQ “Termokos” ka zhvilluar disa projekte të rëndësishme me qëllim të përmirësimit të efijences së energjisë dhe zgjerimit të rrjetit të furnizimit me ngrohje për qytetaret e komunës së Prishtinës.

Gjatë periudhës 6 mujore (janar-qershor) 2025 numri i kyçjeve të konsumatorëve të rinj në rrjetin e ngrohjes ka vazhduar të rritet. Sipas të dhënave nga NQ “Termokos” gjatë periudhës së lartcekur janë kyçur:

- 105 konsumatorë familjarë apo sipërfaqe prej 7,468.38 m²;
- 47 konsumatorë komercial apo sipërfaqe prej 5,163.94 m²;

Projekti: Instalimi i matësve individual të energjisë termike të konsumatorët⁴ –

³ Të dhëna zyrtare nga NQ “Termokos”

⁴ Të dhëna zyrtare nga NQ “Termokos”

Ky projekt është financuar nga Qeveria Amerikane MCC me 10.9 mil. dollarë grant, Komuna e Prishtinës me 2 mil. euro dhe Termokos me 1 mil. euro si bashkëfinancues të këtij projekti.

Kontrata për këtë projekt është nënshkruar në Prill 2022, në mes të MFK (Millenium Foundation-Kosova) dhe kontraktorit “ENERCO LLC” Sh.P.K – Prishtinë, dhe ka filluar së zbatuari me 27.07.2022.

Pas Nëntorit të vitit 2022, është bërë një ndryshim dhe riorganizim në projekt. Bazuar në Marrëveshjen Trepalëshe në mes të MCC, Komunës së Prishtinës dhe NQ “Termokosi”, projekti ka kaluar në përgjegjësi të NQ “Termokosi”. Fondet e mbetura të MCC, janë menaxhuar nga PIU e këtij projekti, e cila deri në fund të projektit është pjesë e NQ “Termokosi”. Faza e parë e këtij projekti ka përfunduar në janar 2025 dhe vlera e projektit në fazën e parë është 12, 91milion euro.

Sipas të dhënave të pranuar nga NQ “Termokos”, lidhur me realizimin e këtij projekti deri me datë 31.05.2025 është bërë instalimi i valvulave termostatike dhe alokatorëve në 19,564 njësi banesore, ku gjithsej deri më tani janë instaluar 79,148 valvula termostatike dhe 58,039 alokatorë të nxehtësisë. Ky aktivitet ka vazhduar ku po ashtu janë instaluar 4,202 matës të energjisë termike, 233 pompa qarkulluese dhe 18 valvola balancuese.

Faza e dytë e projektit për vitin 2025 do të financohet me fondet e NQ “Termokos” si bashkëfinancues i projektit me 1 mil. euro dhe në këtë fazë planifikohet të përfshihen edhe 2,500 konsumatorë të rinj ku do të instalohen:

- Valvula termostatike: 12,347 copë;
- Matës të energjisë termike: 744 copë;
- Pompa qarkulluese: 105 copë;
- Valvola balancuese: 171 copë.

Ndërsa lidhur me programin e faturimit të energjisë përmes matjeve me njehsorë, është bërë faturimi testues dhe krahasues për 2000 konsumatorë në rajone të ndryshme. Gjithashtu NQ “Termokos” është duke shqyrtuar mundësinë e mbështetjes financiare nga donatorët në mënyrë që të krijohet mundësia që të gjithë konsumatorët të faturohen në bazë të konsumit.

5.2. Ngrohtorja Qendrore e Gjakovës

Sipas të dhënave të pranuar nga NQ “Gjakova” sezoni ngrohës ka përfunduar me datën 15.04.2025. Sasia e energjisë termike e prodhuar në periudhën Janar - Prill ka qenë 13,802.2 MWh_{th}, kurse ajo e dërguar tek konsumatorët ishte 7,309.15 MWh_{th}. Ndërsa, gjatë periudhës Janar – Prill 2025 kanë pranuar 5,501.36 ton/biomase me çmim prej 96.17€/ton të mbuluara me subvencione nga Ministria e Ekonomisë në vlerë prej 293,444.01 euro dhe Komuna e Gjakovës 300,000 Euro.

Po ashtu bazuar në të dhënat zyrtare të pranuar nga NQ “Gjakova” gjatë sezonit 2024/2025 numri i përgjithshëm i konsumatorëve të kyçur në rrjet dhe sipërfaqja ngrohëse ka arritur në gjithsej 2,473

konsumatorë prej nga 2,074 janë konsumatorë familjarë kurse 399 konsumatorë komercial dhe institucional me sipërfaqe të përgjithshme ngrohëse prej 124,608 m².

5.2.1 Tarifat e energjisë termike NQ “Gjakova”

Bazuar në Rregulloren ZRRE/Nr. 01/2022 - për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike me të cilën përcaktohen tarifat e ngrohjes në sektorin e rregulluar të energjisë termike. Kjo rregullore zbatohet për ndërmarrjet që kanë licencë për prodhim, shpërndarje dhe furnizim të energjisë termike. Tarifat e energjisë termike të rregulluara për sezonin ngrohës 2024/2025 janë si vijon:

Tabela 15. Tarifat e energjisë termike NQ Gjakova

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2024/2025			
A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.90	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	53.62	
B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.13	0.18
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.77	1.07
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.90	1.25

Projektet në zhvillim - përfshinë zgjerimin e rrjetit gypor që do të financohet nga Kuvendi Komunal Gjakovë si pjesë e projektit të rehabilitimit të tërësishëm të rrugës transite në Gjakovë. Projekti investiv komunal për Ngrohtoren e Gjakovës përfshinë:

- Tri (3) depërtime të rrugës transite “Tirana” me gypa të paraizoluar DN200 me gjatësi totale gypore rreth 550 metra;
- Një (1) vazhdim i segmentit gypor përgjatë rrugës transite me gypa të paraizoluar DN250 me gjatësi totale gypore rreth 600 metra;

Gjatë periudhës monitoruese nga Ngrohtorja Gjakovë është raportuar se në rrjet kanë kyçur konsumatorë të rinj apo sipërfaqe prej 1,418.7 m².

6. Çështjet mjedisore në sistemet e energjisë

Sistemet e energjisë në Kosovë, që përfshijnë kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike (termocentralet dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë – BRE), sistemin e transmetimit, rrjetin e shpërndarjes dhe ngrohtoret qendrore, përballen me një sërë sfidash mjedisore që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Termocentralet, përkatësisht TC Kosova A dhe TC Kosova B, si burimet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend, janë njëkohësisht kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes mjedisore. Djegia e qymyrit (linjtit) si lëndë djegëse primare gjeneron sasi të mëdha të gazrave serrë dhe ndotësve të tjerë si dioksidi i karbonit (CO₂), dioksidi i sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e pluhurit (PM), të cilët ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit dhe shëndetin publik, veçanërisht në zonat përreth Obiliqit dhe Prishtinës.

Nga ana tjetër, rrjeti i shpërndarjes së energjisë përballet me humbje teknike dhe jo-teknike, të cilat jo vetëm që shkaktojnë humbje ekonomike, por edhe rrisin ndikimin mjedisor për shkak të konsumit të panevojshëm të energjisë. Për këtë arsye, përmirësimi i efikasitetit energjetik, modernizimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese, si dhe promovimi i burimeve të pastra të energjisë, paraqesin hapa kyç në drejtim të zvogëlimit të ndikimeve negative mjedisore të sektorit energjetik.

Kosova, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është e obliguar të harmonizojë legjislacionin kombëtar me direktivat e Bashkimit Evropian, veçanërisht Direktivën 2001/80/EC për kufizimin e emisioneve nga impiantet me djegie të mëdha (LCP) dhe Direktivën 2010/75/EU për emisionet industriale (IED). Në këtë drejtim, është hartuar dhe miratuar Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE) 2018–2027, i cili përcakton vlerat kufitare për emetimet e SO₂, NO_x dhe pluhurit nga impiantet ekzistuese si TC Kosova A dhe B, dhe përfaqëson një angazhim për përmbushjen graduale të obligimeve mjedisore të vendit, shih tabelën 16.

Tabela 16. Vlerat kufitare të emisioneve nëpër vite sipas PKZE

Emisionet/vitet	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Pluhuri (ton/vit)	3,302	1,556	883	885	475	475	475	475
SO_x (ton/vit)	10,150	10,111	11,077	11,125	9,497	9,467	9,497	6,129
NO_x (ton/vit)	10,239	8,948	8,948	5,563	6,129	6,129	6,129	6,129

Sipas të dhënave të pranuar nga KEK, përgjatë periudhës janar-qershor 2025 vlerat e emisioneve të ndotësve janë të paraqitura në tabelën 17. Termocentralet në Kosovë, të cilat mbështeten kryesisht në djegien e linjtit, janë burim i madh i ndotësve(SO₂, NO_x, Pluhuri) dhe dioksidit të karbonit (CO₂) në vend. Ky nivel i lartë i emisioneve është rezultat i teknologjive të vjetruara të prodhimit dhe efijencës së ulët të djegies së linjtit.

Tabela 17. Vlerat e emisioneve janar-qershor 2025

TC/Emisionet (ton)	SO ₂	NO _x	Pluhuri	CO ₂
TC A	2,279.61	2,924.06	288.56	1,269,658.72
TC B	3,862.99	3,862.987	1,987.13	1,799,547.97
Gjithsejtë	6,142.60	6,787.05	2,275.69	3,069,206.69

7. Të gjeturat dhe rekomandimet

7.1. Të gjeturat

Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike kanë mbetur të pandryshuara, janë të njëjtat si në vitin 2024. Prodhimi i energjisë elektrike nga kapacitetet vendore ka rënie prej rreth 20.11 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kjo për faktin e ndërprerjes së prodhimit nga njësia B2 e TC Kosova B, meqë është në remont nga muaji prill 2025.

Përgjatë kësaj periudhe ka vazhduar aktiviteti i investimeve në përf forcimin dhe modernizimin e rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes.

Në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike, ZRRE ka vazhduar procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, ku nga 1 qershori 2025 te gjithë konsumatorët që kanë qarkullim

vjetor më shumë së dhjetë (10) milion euro, ose kanë më shumë së pesëdhjetë (50) punonjës, dalin në treg të lirë sa i përket furnizimit me energji elektrike.

Tregu i energjisë ka shënuar përparim me lansimin e tregut “një ditë përpara” dhe atij brenda ditor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Sipas raporteve mujore të ALPEX, në Tregun një ditë përpara në periudhën janar-qershor 2025, rrjedha e energjisë nga zona e ofertimit të Shqipërisë drejt zonës së ofertimit të Kosovës ishte 57,507.98MWh, ndërsa nga zona e ofertimit të Kosovës drejt zonës së ofertimit të Shqipërisë ishte 34,140.71MWh. Ndërkohë, ka vazhduar shkëmbimi i energjisë ndërmjet KEK dhe KESH, eksporti (deponimi në KESH) total i energjisë elektrike si shkëmbim energji për energji në mes të KEK dhe KESH gjatë kësaj periudhe ka qenë 3,550 MWh, kurse importi (marrja nga KESH) ka qenë 1,050 MWh.

Sipas të dhënave të KOSTT, importi i energjisë elektrike për periudhën janar-qershor 2025, është 144% më i lartë se në periudhën e njëjtë të vitit 2024. Pra, përgjatë kësaj periudhe Kosova ka qenë neto importuese e energjisë elektrike në sasi prej 925384.36 MWh,

Nga të dhënat ditore të pranuar nga KOSTT, konsumi nacional në periudhën janar-qershor 2025 ka qenë 3,486,866 MWh, 9.36 % më i lartë se në periudhën e njëjtë në vitin 2024. Në prill 2025, ZRrE ka aprovuar tarifat me pakice të energjisë elektrike për të gjitha kategoritë e konsumatorëve me të drejtë Furnizimit me Shërbim Universal me rritje prej 16.1%, që kanë filluar të mbledhen nga data 1 maj 2025 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Aktivitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së ngrohjes kanë vazhduar përmes ngrohësve Termokos dhe NQ Gjakova. Sipas NQ “Termokos” përgjatë 181 ditëve furnizimi me energji termike janë prodhuar rreth 362,520 MWh kurse janë liferuar rreth 307 GWh energji termike apo 10% më shumë se në sezonin e kaluar. Gjatë periudhës 6 mujore (janar-qershor) 2025 numri i kycjeve të konsumatorëve të rinj në rrjetin e ngrohjes ka vazhduar të rritet. Sipas të dhënave nga NQ “Termokos” janë kyçur 105 konsumatorë familjarë (sipërfaqe prej 7,468.38 m²) dhe 47 konsumatorë komercial (sipërfaqe prej 5,163.94 m²);

Termocentralet Kosova A dhe B, si burimet kryesore të prodhimit të energjisë, janë edhe ndotësit kryesorë të ambientit. Këto dy termocentrale përgjatë kësaj periudhe emetuan gjithsej 3,069,206.69 ton CO₂, si rezultat i teknologjive të vjetruara.

7.2. Rekomandimet

- Mbështetja e KEK-ut sipas nevojës për rehabilitimin sa më të shpejtë të njësies A3, si dhe marrja vendimit për rehabilitimin e njësies së dytë të TC Kosova A, për të përmirësuar eficiencën, rritjen e sigurisë së operimit dhe për të ulur emetimet;
- Zhvillimi i investimeve në njësitet B1 dhe B2 të TC Kosova B për rritjen e kapacitetit prodhues, sigurisë së operimit dhe përmirësimin e komponentës mjedisore të këtyre njësive sa i përket emetimeve të SO₂, NO_x dhe pluhurit;
- Nxitja e investimeve në kapacitete të reja të prodhimit të energjisë elektrike nga BRE për të diversifikuar prodhimin;
- Zhvillimi i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike dhe integrimin më të thelluar rajonal;

- Vazhdimi i investimeve në rrjetin e shpërndarjes dhe ulja e mëtejshme e humbjeve teknike dhe komerciale, me fokus të veçantë në digjitalizimin dhe monitorimin e rrjetit;
- Zbatimi i masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë në të gjitha nivelet: prodhim, transmetim, shpërndarje dhe konsum;
- Fillimi pa vonesa i aktivitetit për ndërtimin e sistemeve të ngrohjes qendrore, sipas studimit të fizibilitetit, në gjashtë komuna të Kosovës sipas prioritetit (Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Mitrovicë Jugore dhe Drenas) si kusht për uljen e konsumit të energjisë elektrike në sezonin e ngrohjes;
- Rishikimi i politikave të energjisë sa i përket diversifikimit të burimeve energjetike;

Aneks 1 – Kapacitetet aktuale prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë

Njësit Prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)	
	Instaluar	Neto
TC Kosova A3	200	144
TC Kosova A4	200	144
TC Kosova A5	210	144
TC Kosova A	610	432
TC Kosova B1	339	264
TC Kosova B2	339	264
TC Kosova B	678	528
TC Kosova A + Kosova B	1288	960
HC Ujmani	35	32
HC Lumbardhi 1	9.08	9.08
HC Lumbardhi 2	6.2	6.19
HC EGU Belaja	8.08	7.5
HC EGU Decani	9.81	9.5
HC Radavci	0.9	0.9
HC Burimi	0.854	0.854
HC Dikanci	3.34	3.34
HC Brodi 1	2.48	2.48
HC Brodi 2	5	5
HC Brodi 3	4.7	4.7
HC Restelica 1&2	2.4	2.4
HC Restelica 3	2.35	2.35
HC Hydroline-Albaniku II	3.55	3.55
HC Hydroline-Albaniku III	4.3	4.3
HC Hydroline-Albaniku IV	1.1	1.1
HC Lepenci 3 (Hidroenergji)	10	10
HC Brezovica (Matkos grup)	2.1	2.1
HC Binqa (EKO Energji)	1	1
HC Sharri	6.45	6.45
HC Vica	4.6	4.6
HC Shterpca	4.9	4.9
HC Dragashi (Renelual Tahiri SH.P.K)	3.4	3.4
HC Orqusha (Renelual Tahiri SH.P.K)	4	4
HC Bresana (Dilli - Energy Sh.P.K.)	0.31	0.31
Total HC	135.904	132.004

Turbinat me ere Air-Energy -KITKA L.L.C	32.4	32.4
SOWI KOSOVA-Selaci 1	34.47	34.47
SOWI KOSOVA-Selaci 2	34.47	34.47
SOWI KOSOVA-Selaci 3	34.47	34.47
Wind Power	1.35	1.35
Total Turbinat me Erë	137.160	137.160
PS Led Light Tehnology	0.102	0.102
PS Birra Peja	3	3
PS FrigoFood (FF) Kosova	3	3
PS SOLAR GREEN ENERGY	3	3
PS N.t.sh. Eling	0.4	0.4
PS Centrali elektrik solar fotovoltaike ONIX	0.5	0.5
PS PRO ENERGY	3	3
PV Eling	1	1
Total Panelet Fotovoltaike	14.002	14.002
BM Ngrohtorja e Qytetit SH.A.	1.2	1.2
Total	1576.266	1244.366